- 1. MIRATOHET:** kërkesa 01Nr.56/2023 e datës 23.03.2023, e parashtruar nga **z.Enver Rugova**, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, për përkrahje me karburant për udhëtim zyrtar dhe përkrahjet **me 60 litra karburant** për vizitë zyrtare në Bashkinë e Shkodrës me datë 24.03.2023.
- 2.** Obligohet Zyrtari i transportit që z.Enver Rugoven, të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit si në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejnë për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Zyrës së Kuvendit.
- 3.** Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Administratë Komunale dhe Zyrtari i Transportit.
- 4.** Vendimi është përfundimtarë.

Vendimi i dërgohet:

- z.Enver Rugova,
- Drejtorisë për Administratë Komunale,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-277/2023	Data: Datum: 23.03.2023	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën 02Nr.59/2023 të datës 21.03.2023, të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Administratë Komunale, për themelimin e komisionit për pranimin e punëve për servisimin e automjeteve të komunës sipas kontratës: “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të institucioneve Komunale”, me numër të jashtë prokurimi 633-23-257-221 dhe me numër të brendshëm 633-023-001-221, nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni për pranimin e punëve për servisimin e automjeteve të komunës sipas kontratës: “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të institucioneve Komunale”, me numër të jashtëm prokurimi 633-23-257-221 dhe me numër të brendshëm 633-023-001-221 dhe në Komision caktohen:

- 1. Sadik Demaj,** Zyrtar për Logjistikë-shofer, Kryesues i Komisionit;
- 2. Bajram Sejdijaj,** anëtar;
- 3. Xhevat Idrizaj,** anëtar;

2. Komisioni i cekur më lartë, ka për obligim që të bëjë pranimin e punëve për servisimin e automjeteve të komunës sipas kontratës së lartcekur; të kontrolloj se cilat pjesë janë vendosur në automjetet e servisuara; të bëjë pranim dorëzimit të pjesëve të vjetra të automjeteve të servisuara me raport të shkruar; të nënshkruhet raporti i pranim dorëzimit nga komisioni dhe operatori i cili i ka servisuar automjetet; të njoftoj Kryetarin dhe Drejtorin e Drejtorisë për Administratë Komunale me një kopje të raportit si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit të tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Obligohet Drejtori i Drejtorisë për Administratë Komunale që të siguroj hapësirën ku do të vendosen pjesët e automjeteve të servisuara dhe në bashkëpunim me komisionin do ti vendosin në atë hapësirë.

4. Përgjegjësin për servisimin e automjeteve të komunës e merr Komisioni.

5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Administratë Komunale.

6. Vendimi është përfundimtar

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit;
- Drejtoria për Administratë Komunale
- “Artoni” D.P.SH dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-276/023	Data: Datum: 22 .03.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën 02Nr.59/2023 të datës 21.03.2023, të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Administratë Komunale, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të institucioneve Komunale”, nxjerr:

V E N D I M

1.CAKTOHET: Menaxheri i kontratës **z. Bashkim Haxhiaj**, Zyrtar për Evidentimin dhe Përcjelljen e Shpenzimeve të Derivate dhe Mirëmbajtës së Automjeteve Zyrtare, për projektin: “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të institucioneve Komunale” me numër prokurimit 633-23-257-221/C702 dhe me numër të brendshëm 633-023-001-221, Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës **CAKTOHET: z.Arben Kabashi**, Drejtor i Drejtorisë për Administratë Komunale, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori ekonomik **D.P.SH.“Artoni”-Banjë**.

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohen që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manuallet për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.

3. Përgjegjësin për realizimin e projekteve të lartcekur e merr: Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Bashkim Haxhiaj, Menaxher i kontratës
- Arben Kabashi, Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës-ZKA
z.Illir FERATI



	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		
Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	Nr.Br.01-275/023	Data: Datum: 22.03.2023	Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 8 të Rregullores 01Nr.187/2022 të datës 29.12.2022, për Kategorizimin e Klubeve Sportive, shqyrtoj kërkesën 12.Nr.40/2023 të datës 16.03.2023 të parashtruar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, për themelimin e Komisionit për ankesa për kategorizimin e klubeve sportive, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni për ankesa për kategorizimin e klubeve sportive dhe në komision caktohen:

- 1.1. Faton Bujupi**, Udhëheqës i Sektorit për Gjendje Civile, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Vlora Gjoci**, Zyrtare për mbrojtje të fëmijëve dhe Riintegrim, anëtare;
- 1.3. Rasim Mahmutović**, Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim, anëtar;

2. Komisioni i cekur me lartë ka për obligim që të bëjë shqyrtimin e ankesave për kategorizimin e klubeve sportive, bazuar në dispozitë të Rregullores 01Nr.187/2022 të datës 29.12.2022, për kategorizimin e klubeve sportive; ti njoftoj me shkrim parashtruesit e ankesave; të njoftoj lidhur me punën e komisionit, Kryetarin e Komunës, Drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

4. Vendimi është përfundimtar

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-272/2023	Data: Datum: 22.03.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe bazuar në Rregulloren për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave 01Nr.68/2021 të miratuar me datë 29.06.2021, Drejtoria për Shërbime Publike, shqyrtoi kërkesën 08 Nr.120-8261 të datës 27.02.2023 të parashtruar nga Bekim Hasanaj nga fsh Belicë, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e babait Ibish Llugini dhe me shkresë 08Nr.59/2023 të datës 08.03.2023, i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 08 Nr.120-8261 e datës 27.02.2023, e parashtruar nga Bekim Hasanaj për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e babait Ibish Llugini dhe sipas Rregullores përkrahet me mjete financiare në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione fondi burimore 21-përfitues individual P.I kodi ekonomik 22220-shpenzime të varrimit nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike.
- 2.** Mjetet e përcaktuara, në pikën 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Bekim Hasanaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
- 3.** Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.
- 4.** Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Bekim Hasanaj,
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor

znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-271/2023	Data: Datum: 22.03.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe bazuar në Rregulloren për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave 01Nr.68/2021 të miratuar me datë 29.06.2021, Drejtoria për Shërbime Publike, shqyrtoi kërkesën 08 Nr.120-10637 të datës 15.03.2023 të parashtruar nga Hamdi Sadikaj nga fsh Prigodë, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e nënës Kaja Sadikaj dhe me shkresë 08Nr.144/2023 të datës 17.03.2023, i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 08 Nr.120-10637 e datës 15.03.2023, e parashtruar nga Hamdi Sadikaj, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e nënës Kaja Sadikaj dhe sipas Rregullores përkrahet me mjete financiare në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione fondi burimore 21-përfitues individual P.I kodi ekonomik 22220-shpenzime të varrimit nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike.
- 2.** Mjetet e përcaktuara, në pikën 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Hamdi Sadikaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
- 3.** Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.
- 4.** Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimin të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Hamdi Sadikaj,
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
Kryetari Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-270/2023	Data: Datum: 22.03.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe bazuar në Rregulloren për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave 01Nr.68/2021 të miratuar me datë 29.06.2021, Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, shqyrtoi kërkesën 08 Nr.120-10171 të datës 10.03.2023 të parashtruar nga Naim Ferizaj nga fsh Muzhevinë, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e babait Zenun Ferizaj dhe me shkresë të 08Nr.145/2023 të datës 17.03.2023 dhe i propozon Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 08 Nr.120-10171 e datës 10.03.2023, e parashtruar nga Naim Ferizaj, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e babait Zenun Ferizaj dhe sipas Rregullores përkrahet me mjete financiare në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione fondi burimore 21-përfitues individual P.I kodi ekonomik 22220-shpenzime të varrimit nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Naim Ferizaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.
4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimin të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Naim Ferizaj,
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 269/023	Data: Datum: 22.03.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-1238 të datës 10.01.2023, të parashtruar nga z.Sinan Maraj, nga fsh.Vrellë, Komuna e Istogut për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-1238, e datës 10.01.2023, e parashtruar nga z.Sinan Maraj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **150.00€ (njëqindë e pesëdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor, administrata në Shëndetësi, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Sinan Maraj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Sinan Maraj, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-1238, të datës 06.02.2023, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Sinan Maraj është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapinë për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **150.00€ (njëqindë e pesëdhjetë euro)**.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi, është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Sinan Maraj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- z.Sinan Maraj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01- 267/023	Data: Datum: 22.03.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 12 par 12.3 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.04/L-081, nenin 6, 7 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2011 për punët dhe kriteret e vendosjes së rezidentëve në shtëpinë e personave të moshuar pa përkujdesje familjare dhe në shtëpinë me bazë në komunitet, Komisioni i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale për shqyrtimin e kërkesave dhe pranimin e rezidentëve në Shtëpinë e Komunitetit në Gurakoc, shqyrtoi kërkesën Nr.633/2022, të datës 29.06.2022, të parashtruar nga Qendra për Punë Sociale Istog, për lejin e strehimit të përherëshëm institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, për Rexhep (Gjeladin) Zogaj, nga fshati Kaliqan, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit të Komunës të nxjerrë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.633/2022, të datës 29.06.2022, e parashtruar nga Qendra për Punë Sociale e Istogut, për lejin e strehimit të përherëshëm institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, për Rexhep (Gjeladin) Zogaj, me nacionalitet shqiptar, me shtetësi kosovar i lindur me 24.05.1953, në fshatin Kaliqan, Komuna e Istogut.
2. Komisioni për rastin në fjalë ka vendos ti lejoj strehimin e përherëshëm pas perfundimit të qëndrimit 6 mujor si periudhë testuese lidhur me akomodimin e tij.
3. Shtëpia e Komunitetit në Gurakoc është përgjegjëse për përkujdesjen ndaj Rexhep (Gjeladin) Zogaj, gjatë qëndrimit në këtë institucion.
4. Obligohet Organi i Kujdestarisë pranë QPS-së që të përcjell dhe të mbikqyrë gjëndjen e klientit në shtëpinë e komunitetit në Gurakoc.
5. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Komisioni i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale shqyrtoj, kërkesën Nr.633/2022 të datës 29.06.2022, e parashtruar nga Qendra për Punë Sociale Istog, për strehimin e të moshuarëve, shqyrtoi dosjen e Rexhep (Gjeladin) Zogaj i cili ka jetuar në Kaliqan në shtëpi i vetëm dhe pa përkujdesje familjare, pasi që vëllezerit dhe motrat e tij janë poashtu në moshë dhe jetojnë jashtë shtetit të Kosovës, dhe gjendja e tij si i vetëm ka filluar te komplikohet. Gjendja shëndetësore e tij për momentin është e mirë pa probleme mendore, statusi familjar nuk ka bashkëshortë fëmijë biologjik as të adoptuar ka tre vëllëzër dhe dy motra.

Komisioni për rastin në fjalë ka vendos ti lejoj strehimin e tij në Shtëpinë për Komunitete në Gurakoc në mënyrë të përherëshëm pas perfundimit të periudhës 6 mujore si fazë testuese lidhur me qëndrimin e tij në shtëpi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimin të këtij Vendimi

Vendimi i dërgohet;

- Rexhep (Gjeladin) Zogaj,
- Merita Muzlija-Bytyçi, Drejtoreshë për Mirëqenie Sociale
- Haki Ibrahimaj, Drejtori QPS-Istog,
- Menaxheri për Shtëpi të Komuniteteve në Gurakoc dhe
- Arkiva e Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
Ilir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-266/2023	Data: Datum: 21.03.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në Ligjin Nr. 2003/24/2008 për Sport dhe në nenin 7 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ 03/2015 për Themelimin dhe Regjistrimin e Klubeve Publike dhe Private të Sportit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, shqyrtoj kërkesën 12Nr.016-10535 të datës 14.03.2023, të parashtruar nga OJQ "Klubi Alpin Podguri", përfaqësuesi z.Masar Kabashi, Komuna Istog, për Themelimin dhe regjistrimin e klubit dhe me shkresën 12Nr.39/2023 të datës 16.03.2023 i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 12Nr.016-10535 e datës 14.03.2023, e parashtruar nga OJQ "Klubi Alpin Podguri", përfaqësues z.Masar Kabashi, për Themelimin dhe regjistrimin e klubit në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.

2. I lartpërmenduri i ka plotësuar kriteret për Themelimin dhe regjistrimin e OJQ "Klubi Alpin Podguri" duke sjell dokumentet siç janë;

- 2.1. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;
- 2.2. Statuti;
- 2.3. Rregullorja e punës së Kuvendit;
- 2.4. Rregullorja e punës së Bordit;
- 2.5. Rregullorja e punës së Këshillit Mbikëqyrës;
- 2.6. Dëshmi mbi kushtet e nevojshme për funksionimin normal të OJQ-së (selia, kuadri profesional i kualifikuar, hapësira dhe pajisjet për zhvillimin e aktiviteteve);
- 2.7. Akti themelimit;
- 2.8. Nënshkrimet e themeluesve të klubit, numrat dhe kopjet e Letërnjoftimeve;
- 2.9. Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit Themelues;
- 2.10. Vendimi për zgjedhjen e Bordit Drejtues, Kryetarit dhe Këshillit Mbikëqyrës;

3. OJQ "Klubi Alpin Podguri" është Themeluar dhe regjistruar nga data 21.03.2023, ka kuadër profesional të kualifikuar, hapësira dhe pajisje për zhvillimin e aktiviteteve.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.

5. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të Vendimit në Departamentin e Sportit në Ministrinë për Kulturë Rini dhe Sport.

Vendimi i dërgohet:

- Masar Kabashit,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
 z. Ilir FERATI



 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality	KRYETARI I KOMUNËS PRESDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova
	Nr. Br. 01-265/2023	Data: Datum: 21.03.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 59 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në nenin 21 paragrafi 2, dhe në nenin 44, paragrafi 1 dhe 4, nënparagrafi 4.1 të Rregullorës (QRK) Nr.22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, Komisioni komunal për Riintegrim shqyrtoj kërkesën 10 Nr.553-6433 të datës 14.02.2023 të parashtruar nga Burhan Mahmutaj nga Komuna e Istogut e riatdhesuar nga Gjermania dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **REFUZOHET:** kërkesa 10 Nr. 553-6433 e datës 14.02.2023 e parashtruar nga **Burhan Mahmutaj** i riatdhesuar nga **Gjermania** me datën **01.12.2022**, për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegritit për vazhdimin e akomodimit me qira edhe për 7 muaj, sipas kërkesës së të riatdhesuarit.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni Komunal për Riintegrim me datën 20.03.2023 ka shqyrtuar kërkesën 10 Nr.553-6433 e datës 14.02.2023 të parashtruar nga i riatdhesuari Burhan Mahmutaj për vazhdimin e Akomodimit më qira edhe për 7 muaj, pas datës 01.03.2023.

Kryetari shqyrtoi procesverbalin e Komisionit Komunal për Riintegrim të datës 20.03.2023 për refuzimin e kërkesës së lartëpërmendur dhe miraton refuzimin e saj.

Komisioni ka shqyrtuar të gjitha dokumentet e prezantuar dhe sipas dëshmive të paraqitura konstaton i riatdhesuar Burhan Mahmutaj ka shfrytëzuar maksimumin e lejuar të Akomodimit me qira sipas nenit 21, paragrafit 2 të Rregullorës QRK 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (12 muaj, nga data 01.03.2022 deri me 01.03.2023).

Duke qenë se i riatdhesuar nuk e dëshmon me dokumentacion asnjë kategori të cënueshmërisë sipas nenin 33, paragrafit 1 dhe nënparagrafeve nga 1.1 deri në 1.11 të Rregullorës QRK 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, kërkesa e tij u refuzua.

Për sa u tha më lartë u vendos sin ë dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa. Ankesa dorëzohet brenda 2 ditëve në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim për procedim në Departamentin për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar për shqyrtim nga Komisionin i Ankesave, në afat pre 30 ditëve nga data e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- Burhan Mahmutaj,
- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.
- Departamentin për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar,
- Ministria e Mjedisit, Planifikimt Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ

Kryetari i Komunës
z. Ilir Ferati


 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
 Qales-Klezna
 Nr. 01-06-11701 Data 22.03.2023
 Br: Datum
 ISTOG-ISTOK


 REPUBLIKA E KOSOVËS
 OPŠTINA ISTOK
 REPUBLIKA KOSOVO

 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality	KRYETARI I KOMUNËS PRESDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova
	Nr. Br. 01-264/2023	Data: Datum: 21.03.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 59 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) në nenin 35, në nenin 21 dhe në nenin 44, paragrafi 1 dhe 4, nënparagrafi 4.1 të Rregullorës (QRK) Nr.22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, Komisioni komunal për Riintegrim shqyrtoj kërkesën 10 Nr.553-10304 të datës 13.03.2023 të parashtruar nga Arsim Shabanaj nga Komuna e Istogut e riatdhesuar nga Zvicra dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 10 Nr. 553-10304 e datës 13.03.2023 e parashtruar nga **Arsim Shabanaj** riatdhesuar nga **Gjermania** me datën **14.02.2023**, për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegritimit për akomodim me qira për **12** muaj, në vlerë 180.00€ (njëqind e tetëdhjetë euro) në muaj, duke i përfshirë edhe shpenzimet komunale.
2. Përfitues është **Arsim Shabanaj**, rast individual i riatdhesuar.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Ministria e Punëve të Brendshme.
4. Për ekzekutimin e pagesës së qirasë nga data **10.04.2023** deri me **09.04.2024** obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
5. Venidimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni Komunal për Riintegrim me datën 20.03.2023 ka shqyrtuar kërkesën 10 Nr.553-10304 e datës 13.03.2023 të parashtruar nga **Arsim Shabanaj** për përfitim nga Masat e Emergjente të Riintegritimit për akomodim me qira. Kryetari shqyrtoi procesverbalin e Komisionit Komunal për Riintegrim të datës 20.03.2023 për miratimin e kërkesës së lartëpërmendur dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshëm dhe e miraton.

Komisioni ka shqyrtuar të gjitha dokumentet e prezantuar dhe sipas dëshmime të paraqitura konstaton se **Arsim Shabanaj** i riatdhesuar i plotëson kriteret për mbështetje nga Masat Emergjente të riintegritimit për akomodim me qira për 12 muaj, në vlerë prej 180.00€ (njëqind e tetëdhjetë euro) në muaj, duke i përfshirë edhe shpenzimet komunale. Sipas kërkesës së riatdhesuarit, data e fillimit të pagesës do të jetë nga data 10.04.2023. Ekzekutimin e pagesës së qirasë nga data 10.04.2023 deri me 09.04.2024 sipas këtij Vendimi obligohet të bëjë Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Për sa u tha më lartë u vendos sin e dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa. Ankesa dorëzohet brenda 2 ditëve në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim për procedim në Departamentin për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar për shqyrtim nga Komisionin i Ankesave, në afat prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- Arsim Shabanaj,
- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.
- Departamentin për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar,
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ

Zekije SUTAJ

REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Udhëheqëse

Nr. 01-016-11700
 Br:

Data 22.03.2023
 Datum

ISTOG-ISTOK

Kryetari i Komunës
 z. Ilir Ferati



	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		
Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	Nr.Br. 01-263/023	Data: Datum: 21.03.2023	Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të Komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, bazuar në Marrëveshjen e bashkëpunimit me Qendrën Korrektuese të Dubravës 01Nr.355/2022 të datës 27.05.2022, MD/Shërbimit Korrektues të Kosovës i jepen donacion dy autoambulanca për nevoja shëndetësore, nxjerr:

V E N D I M

1. I jepen donacion dy autoambulanca MD/Shërbimit Korrektues të Kosovës për nevoja shëndetësore, Volkswagen me numër të shasisë VW2ZZZ70ZSH131123 dhe Citroen me numër të shasisë VS7YA2MSB12C85246.
2. Autoambulancat e lartpërmendura kalojnë me donacion në pronësi të MD/Shërbimit Korrektues të Kosovës.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: MD/Shërbimit Korrektues të Kosovës
4. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- MD/Shërbimit Korrektues të Kosovës,
- Shefit të Autoparkut dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ**



**Kryetari Komunës
z.Illir FERATI**



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-262/2023	Data: Datum: 21.03.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën 09Nr.39/2023 të datës 20.03.2023 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: “Katër konsulentë individual për subvencione dhe punë profesionale në bujqësi-633-023-005-321”, nxjerr:

V E N D I M

- 1. ÇAKTOHET:** Menaxher i kontratës **Valbona Kaliqanaj**, Zyrtare e Lartë për Pemëtarin në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe **ÇAKTOHET:** Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës **Astrit Hajrizaj**, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, për projektin: “Katër konsulentë individual për subvencione dhe punë profesionale në bujqësi-633-023-005-321”, me numër prokurimi 633-023-1041-2-2-1, të cilin projekt e kanë fituar për ta realizuar konsulentët: **Qendrim Kajtazaj** nga f.sh Dragolevc; **Egzon Kabashi** nga fsh. Tomoc; **Gentrita Salihaj** nga Gurrakoci; **Kaltrina Kukleci** nga fsh Lluga.
- Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
- Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e merr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.
- Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe fillon të zbatohet menjëherë.
- Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Valbona Kaliqani-Menaxher i kontratës,
- Astrit Hajrizaj-Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës;
- Qendrim Kajtazaj,-konsulentë,
- Egzon Kabashi-konsulentë,
- Gentrita Salihaj- konsulentë,
- Kaltrina Kukleci-konsulentë dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




Zyrtari Kryesor Administrativ
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.261/2023	Data: Datum: 21.03.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 58 shkronja (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale publikuar në (Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.28/2008) :

Propozon

Kuvendit të Komunës ,që në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika (d) dhe nenit 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) e në lidhje me nenin 11,paragrafi 4 të Ligjit Nr.-06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës në kuptim të nenit 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010,në mbledhjen e mbajtur më 21.03.2023 mori këtë :

V E N D I M

1.Të bëhet këmbimi i pronës së paluajtshme të Komunës së Istogut me pronën e paluajtshme në pronësi private të z.Ismet (Avdyl) Halimaj nga fsh.Dragolec K- Istog me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm publik përkatësisht zgjerimi i Stadiumit “Demush Mavraj” në Istog.

2.Sipas pikës 1 të këtij vendimi Njësia Kadastrale me Nr.P-70806020-00700/2 në sipërfaqe të përgjithëshme prej 900m² ZK Istog i Poshtëm evidentuar në pronësi të z.Ismet (Avdyl) Halimaj kështu që nga pjesa e përgjithëshme, pjesa e sipërfaqes prej 335 m² do të këmbëhet me pjesën nga njësia kadastrale P-70806020-00165-0 evidentuar në emër të Komunës së Istogut.Pas miratimit të këtij vendimi vlerësimin e pronës që është objekt i këmbimit do ta bëjë zyra për vlerësimin e pronës së paluajtshme e cila është në kuader të Departamentit të Tatimit në pronë pranë Ministrisë së Financave.

3.Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja dhe për realizimin e tij kujdesen,Kryetari i Komunës si dhe Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi në Komunën e Istogut.

Më nga një kopje të këtij vendimi të njoftohen: Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi ,një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit, si dhe në dosje.

Udhëheqësja e Zyres Ligjore
z.Zekije Sutaj



Kryetari Komunës
z.Illir Ferati



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-258/023	Data: Datum: 16.03.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13, nenin 17 pika k) dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010 i miratuar me datën 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën e Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale të datës 02.03.2023 të parashtruar përmes Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, për ndarjen e mjeteve buxhetore për pagesën e qirasë dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- MIRATOHET:** kërkesa e Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale të datës 02.03.2023, të parashtruar përmes Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, për ndarjen e mjeteve buxhetore për pagesën e qirasë dhe ndahen mjete buxhetore për pagesën e qirasë për Meda Memić, viktimë e dhunë në familje e cila ka tre fëmijë dy të moshës mbi 12 vjet dhe i ndahen mjete buxhetore për qira në shumë prej **450€ (katërqind e pesëdhjetë euro) për tre (3) muaj.**
- Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga 150€ (njëqind e pesëdhjetë euro) në muaj, për tre muaj në xhironlogarinë e Agim Nimanaj-qiradhënës nga programi buxhetor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, përfitues individual.
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Mirëqenie Sociale.
- Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Meda Memić,
- Drejtorisë për Mirëqenie Sociale dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
Z. IIR FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-257/023	Data: Datum: 16.03.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2020 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën e Drejtorisë për Ekonomik dhe Zhvillim të datës 16.03.2023, për themelim të komisionit për verifikimin e punëve për projektin: “Zhvillimi i infrastrukturës rrugore dhe bujqësore në Komunën e Istogut dhe Pejës”, me numër prokurimi 633-022-8911-5-2-1/C618”, nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni për verifikimin e punëve për projektin: “Zhvillimi i infrastrukturës rrugore dhe bujqësore në Komunën e Istogut dhe Pejës”, me numër prokurimi 633-022-8911-5-2-1/C618”, të cilin projekt e ka realizuar operatori “**SHKEMBI**” SHPK nga Istogu dhe në komision caktohen:

- 1.1. Rasim Mahmutović, Inxh.** Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Albert Hasanaj,** Zyrtar për Zhvillim, anëtar dhe
- 1.3. Fisnik Shoshaj,** Zyrtar Ligjor 2, anëtar.

2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të Menaxherit të kontratës; do të hartojë procesverbalin gjatë verifikimit të punimeve në terren; do të hartoj raportin e pranimin teknik të projektit; do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur; si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për verifikimin e punëve për projektin e lartcekur e merr Komisioni, Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Prokurimi.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimi,
- Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim,
- SHKEMBI-SHPK operator
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ

[Signature]

Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-256/023	Data: Datum: 16.03.2023	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008), në nenin 10 pika b) të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.27/2008) dhe Ligji 06/L-021 për kontrollin e financave publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.27/2008, anulohet Vendimi 01 Nr.426/2022 i datës 22.06.2022 dhe emërohet Zyrtari zëvendësues-alternativ të Zyrtarit Kryesor Financiar, nxjerr:

V E N D I M

1. **EMROHET: Qendrim Ibrahimaj**, Zyrtar zëvendësues-alternativ i ZKF-së i cili ka pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa.
2. I lartëpermënduri, mund t'ia filloj me punë vetëm në mungesë të Zyrtarit Kryesor Financiar, në mungesë të tij i ushtron të gjitha përgjegjësitë që i lejohen me Ligjin Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, Ligjin e Buxhetit dhe aktet tjera nënligjore duke përfshirë shkresën qarkore të datës 12.01.2021 deri në kthimin e ZKF-së në detyrë.
3. Obligohen që të përdorë SIMFK sipas Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit dhe akteve nënligjore në fuqi që rregullojnë këtë fushë.
4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: Qendrim Ibrahimaj dhe ZKF.
5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Osman Sdikaj, ZKF,
- Qendrim Ibrahimaj, Zyrtar zëvendësues-alternativ i ZKF-së
- Arta Fetahu dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

[Signature]

